



Tiranë, më 16.11.2022

Drejtuar: **BASHKIA VORË**
Z. BLERIM SHERA
Kryetar

Për dijeni: **Agjencia Kombëtare e Mjedisit**
Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë
Hekurudha Shqiptare

Lënda: Informacion dhe Vënie në dijeni për Organizimin e Dëgjësës me Publikun në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Rehabilitimin e hekurudhës Vorë - Hani i Hotit, Shqipëri

I nderuar z. Shera,

Hekurudha Shqiptare dhe konsulenti Abkons, në vijim të letrës së parë të dërguar në adresë të bashkisë Vorë për Vënie në dijeni për Dëgjësën me Publikun në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Rehabilitimin e hekurudhës Vorë - Hani i Hotit, Shqipëri dhe gjithashtu vënie në dispozicion të informacionit për projektin dhe vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe masat zbutëse, për tu prezantuar në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse, dërgon letrën e dytë në lidhje me datën, orën dhe vendin ku do të mbahet dëgjesa me publikun për këtë qëllim.

Kërkojmë që përfaqësues të Bashkisë Vorë të jenë pjesë e konsultimit me publikun i cili do të zhvillohet për territorin e Bashkisë Vorë, më datë 5 Dhjetor 2022, ora 9:00, pranë ambienteve të Hotel Continental, Vorë.

Me qëllim informimin dhe përfshirjen e publikut dhe të gjithë aktorëve vendorë të interesuar, në mënyrë që të arrijmë zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët e prekura kërkojmë mbështetjen tuaj për organizimin e takimeve konsultuese me palët e interesuara që mund të ndikohen/preken nga aktivitetet e parashikuara nga punimet rehabilituese të linjës hekurudhore. Pjesëmarrja, njoftimi dhe informimi i të gjithë personave të interesuar do të ishte i rëndësishëm dhe për shoqërinë dhe për komunitetin në tërësi të vendbanimeve në afërsi të të cilave kalon linja hekurudhore.

Kështu që vlerësohet me shumë interes informimi, njoftimi dhe pjesëmarrja në këtë takim e:

- Punonjësve të Bashkisë Vorë që mbulojnë aspektet mjedisore, sociale, zhvillimin e territorit, ujësjellës kanalizime, mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes dhe kullimit, etj.;
- Kryetarët dhe punonjësit e njësive administrative që janë pjesë e Bashkisë Vorë dhe që preken nga gjurma e hekurudhës;
- Kryepiqetë e fshatrave Marqinet, Shargë, Gjeç Kodër, Gjeç Fushë, Fushë Prezë, Ahmetaq;
- Banorë dhe biznese të vendbanimeve/fshatrave në afërsi të linjës hekurudhore;
- Përfaqësues të institucioneve arsimore dhe shëndetësore në afërsi të linjës hekurudhore;
- Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë dhe/ose zbatojnë projekte në vendbanimet në afërsi të zonës së projektit, nëse ka të tilla, etj.

Pikat e kontaktit për këtë proces konsultimesh do të jenë:

1. Adresën Postare: Pranë Hekurudha Shqiptare, Lagjia nr. 3, Rruga Egnatia, Durrës/ose në adresën Elektronike: [eriton.hasaj@hekurudha.al/](mailto:eriton.hasaj@hekurudha.al) ose numrin e telefonit: +355 67 222 1452;
2. Adresën Postare: Pranë Abkons, Rr. Themistokli Gërmenji, Tiranë/ose në adresën Elektronike: [Lproko@abkons.com/](mailto:Lproko@abkons.com) ose numrin e telefonit: +355 68 903 7787.

Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj gjatë gjithë procesit të komunikimit me palët e interesuara në nivel vendor të këtij projekti të rëndësishëm jo vetëm për Hekurudhën Shqiptare por për të gjithë vendin.

Me respekt,
Redion Biba
Administrator Abkons

